

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 5462 / Prot

23.10 .2023

Nr. 665 , datë 23.10 .2023

PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PRANIMIN NË LISTËN E EKSPERTËVE
VLERËSUES TË VLERAVE KULTURORE TË PASURIVE TË LUAJTSHME, TË
PALUAJTSHME DHE JOMATERIALE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 59, të ligjit nr. 27/2018, “Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe pranimi në listën e përzgjedhjes të ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale.
2. Aplikanti i cili kërkon të përfshihet në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale, duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si më poshtë:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar;
 - b. të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional”, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
 - c. të ketë përvojë pune në profesion sipas përcaktimeve në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij udhëzimi;
 - d. të ketë përgatitje të lartë profesionale;
 - e. të mos jetë i dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me profesionin;
 - f. të mos ketë masë disiplinore në fuqi (në fushat përkatëse);
- 2.1 Përfshimisht, shtetasit e huaj të cilët janë ekspertë të komisioneve këshillimore dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim dhe ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, aplikojnë për përfshirjen në listën e ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale.
3. Aplikanti i cili kërkon të përfshihet në listën e ekspertëve pranë **Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK)**, për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme duhet të plotësojë kriteret specifike si më poshtë:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional” në arkeologji, histori, arkitekturë, inxhinieri dhe/ ose të zotërojnë diplomë “Doktor i Shkencave” në fushat e mësipërme, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë ose të ketë diplomë ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) Të ketë licencë në arkeologji/projektim/zbatim/mbikëqyrje/ kolaudim, në një ose disa nënkategori, në pasuri kulturore sipas legjislacionit në fuqi;
 - c) Të ketë të dokumentuar përmes publikimeve në revistat shkencore brenda ose jashtë vendit, veprimtarinë kërkimore shkencore lidhur me fushën e veprimtarisë për të cilën aplikon si ekspert;
 - d) Kualifikime në fushën dhe gjininë specifike të pasurisë kulturore për të cilin do të kryhet vlerësimi, nëse ka.
4. Aplikanti i cili kërkon të përfshihet në listën e ekspertëve, **pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK)** për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme duhet të plotësojë kriteret specifike si më poshtë:
- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional” në arkeologji, trashëgimi kulturore, etnografi, art pamor, numizmatikë, filateli, bukinizm ose në një fushë tjetër të ngjashme me të;
 - b) Të ketë ushtruar aktivitet të paktën për një periudhë 5 (pesë) vjeçare si: galerist, ekspert vlerësimi, koleksionist në fusha të ndryshme të lidhura me trashëgiminë kulturore;
 - c) Të ketë të dokumentuar përmes certifikatave përkatëse të lëshuara brenda ose jashtë vendit, ekperiencën lidhur me fushën e veprimtarisë për të cilën aplikon si ekspert;
 - d) Në rastet kur ka përfunduar studimet universitare në një fushë tjetër nga sa permendet në germën (a), dhe/ose të ketë referenca nga organizata jofitimprurëse apo grupe interesi në fushën e kërkuar, dhe/ose të ketë eksperiencë të provuar në fushën e ekspertizës së propozuar prej të paktën 10 (dhjetë) vitesh.
5. Aplikanti i cili kërkon të përfshihet në listën e ekspertëve, **pranë Qendrës Kombëtare të Veprimtarisë Tradicionale (QKVT)**, për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë jomateriale duhet të plotësojë kriteret specifike si më poshtë:
- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional” në Muzikologji ose Trashëgimi Kulturore;
 - b. Të ketë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vite përvojë profesionale;
 - c. Të ketë marrë pjesë në ideimin dhe organizimin e veprimtarive tradicionale në nivel lokal e kombëtar;
 - ç. Të ketë qenë pjesë e grupeve të punës dhe stafit të ekspeditave mbledhëse dhe studimore duke dhënë kontribut edhe me anë të publikimit të ngjarjeve dhe fenomeneve që lidhen me Trashëgiminë Kulturore Jomateriale.

6. IKRTK, IKTK dhe QKVT në rast se krijohen vakanca si pasojë e mbarimit të mandatit, sipas përcaktimeve në pikat 9 dhe 10, të Kreut II të Udhëzimit *“Për mënyrën e funksionimit të Komisioneve Këshillimore për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore në pasuritë e luajtshme të paluajtshme dhe jomateriale”*, publikojnë në faqen zyrtare njoftimin për paraqitjen e shprehjeve të interesit për të aplikuar në listën e ekspertëve vlerësues.
7. Njoftimi për paraqitjen e shprehjeve të interesit:
 - a) qëndron e hapur për të paktën 30 (tridhjetë) ditë;
 - b) përcakton informacionin dhe dokumentacionin që duhet të dorëzohet nga aplikantët;
 - c) afatin dhe mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit.
8. Aplikanti duhet të depozitojë në rrugë postare, ose në rrugë elektronike, sipas thirrjes së publikuar, dokumentacionin si më poshtë:
 - a) shprehjen e interesit me shkrim;
 - b) jetëshkrimin e përditësuar;
 - c) kopje të dokumentit të identifikimit;
 - ç) kopje të diplomës, që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për fushën përkatëse të ekspertizës, ose diplomë të njehsuar me të;
 - d) kopje të librezës së punës ose vërtetim se aplikanti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit;
 - dh) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
9. IKRTK, IKTK, QKVT verifikojnë nëse kandidatët që kanë paraqitur shprehjen e interesit plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe kriteret specifike të parashikuara në këtë udhëzim. Lista me kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit.
10. Aplikuesit, të cilët nuk kualifikohen për pranimin si ekspertë vlerësues, njoftohen me shkrim, individualisht.
11. Kundër vendimit, aplikuesi ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit pranë Ministrisë të Kulturës, i cili merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.
12. Ndaj vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.
13. IKRTK, IKTK, QKVT i përcjell ministrit për miratim listën me ekspertët vlerësues, në funksion të përzgjedhjes së tyre në përbërje të Komisioneve Këshillimore e cila, pas miratimit, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të afateve të përcaktuara në pikën 11 të këtij Udhëzimi.
14. Në rast se në përfundim të thirrjes së parë, nuk paraqesin interes më shumë se 3 (tri) aplikantë për secilin institucion thirrja do të ri-shpallet. Pas plotësimit të përzgjedhjes së 5 (pesë) anëtarëve të komisioneve këshillimore për secilin institucion, lista me

antarët e tjerë të kualifikuar, kur janë jo më pak se 3 (tri) aplikante, do të jetë e vlefshme vetëm për 2 vjet.

15. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi IKRTK, IKTK dhe QKVT.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

ELVA MARGARITE

